

**Njoftim përqendrimi me të cilin ORBIKO SHPK për tregti Zagreb**

**Republika e Kroacisë do të fitojë kontrollin mbi HBI ITALIA AKVIZICIJA CO. S.R.L., Itali**

**(lënda nr. 08-132/2024)**

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 19.09.2024, dhe plotësuar më 04.10.2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim me të cilin ORBIKO SHPK për tregti Zagreb, me seli në rr. Koturashka Cesta 69, Zagreb, Republika e Kroacisë, synon të fitojë kontrollin mbi HBI ITALIA AKVIZICIJA CO. S.R.L., me seli në Via Del'Agricoltura 51, KARPI (MO) KAP 41012, Itali.

**Pjesëmarrësit e përqendrimit dhe aktivitetet e tyre të biznesit:**

**ORBIKO SHPK për tregti Zagreb**, me seli në rr. Koturashka Cesta 69, Zagreb, Republika e Kroacisë, MBS: 080234144, dhe me subjekt të operacioneve tregtare.

E pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes:

Shoqërisë për tregti dhe shërbime ORBIKO SHPK Shkup, me seli në rr. Boris Trajkovski nr. 286, Komuna Kisela Vodë, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe

me NUAS 5024277, dhe me subjekt operimi: 46.90 - tregti me shumicë e pa specializuar (si shoqëri nga e cila 96.463% është pronë e Orbiko SHPK për tregti Zagreb)

**HBI ITALIA AKVIZICIJA CO. S.R.L.**, me seli në Via Del'Agricoltura 51, KARPI (MO) KAP 41012, Itali dhe subjekt i operimit – aktivitetet e shoqërive holding (subjekt mbi të cilin kontrolli fitohet duke blerë aksione që përfaqësojnë 100% të kapitalit aksionar dhe 100% vota në vendimmarrje – Subjekti i synuar), si dhe degët (firmat bijë) të subjektit të synuar:

- ÇEMPION JUROP SOCIETA' A RESPONSABILITA' LIMITATA, me seli në Via Del'Agricoltura 51, KARPI (MO) CAP 41012, Itali me aktivitet prioritar operimi : tregti me shumicë e rrobave dhe këpucëve dhe aktivitet sekondar: Aktivitetet e shoqërive mbajtëse (100% në pronësi të subjektit të synuar);

- ÇEMPION PRODUKTS JUROP LIMITED, me seli në 8 Plaza 212, Blançardstaun Korporejt Park 2, Blançardstaun, Dublin 15, Dublin, Irlandë me subjekt operimi : komercializimi i produkteve sportive, menaxhimi, zhvillimi dhe kontrolli i aktivitetit të licencës, marketingu dhe promovimi i markës tregtare (100% në pronësi të ÇEMPION JUROP SOCIETA' A RESPONSABILITA' LIMITATA);

- SHAMPION GERMANIA SHPKNJP, me seli në Zidvestpark 63, 90449 Nuremberg, Gjermani, me subjekt operimi: prodhimi, tregtimi, shitja dhe shpërndarja e mallrave të konsumit dhe artikujve të markës, veçanërisht veshjeve sportive dhe rekreative të çdo lloji dhe çdo aksesori për të, si dhe ofrimi i shërbimeve që lidhen me këto produkte, si dhe menaxhimi i fushave të ndryshme të biznesit që kanë të bëjnë me prodhimin, marketingun, shitjen dhe shpërndarjen e këtyre mallrave dhe ofrimin e shërbimeve në lidhje me to (100%) në pronësi të ÇEMPION PRODUKTS JUROP LIMITED të Irlandës);

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

09.10.2024

Shkup